



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Nr. \_\_\_\_ prot.

Prrenjas, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi i terreneve sportive tek shkolla e mesme “Halit Berzeshta”**

”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

45212222-8

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1.250.000 (nje milion e dyqind e pesedhete mije) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Njësia e Prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedures është e hapur e thjeshtuar, nën kufirin e ulët monetar, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bere ne mbeshtetje te nenit 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij., VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

### **2.3. Kapaciteti teknik:**

**Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:**

#### **2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

#### **ose**

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

#### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

- Për kontrata të realizuara me ente/institucione publike, OE duhet të paraqesë:
  - Formularin e vlerësimit, sipas shtojcës 9, shoqëruar me:
  - Kontratën/at e sipërmarrjes;
  - Situacionin përfundimtar të objektit;
  - Faturën/at tatimore
  - Aktin e kolaudimit;
  - Certifikatën e marrjes në dorëzim (të përkohëshme/përfundimtare)
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesë:
  - Kontratën/at e sipërmarrjes;
  - Situacionin përfundimtar të objektit;
  - Faturën/at tatimore

Në rast se oferta paraqitet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 2.3.1, gërma “a”, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1, gërma “b”, duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

- 2.3.2.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 7 (shtate) punonjës të siguruar, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin e kërkuar;
  - Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit,

*përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- 1 (një) Inxhinier ndërtimi

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i inxhinierëve 1 (një) inxhinier ndërtimi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierëve:

**2.3.4.** Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Eskavator 0.25 m3	Në pronësi ose me qira	1
2	Kamion mbi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Kamioncine deri ne 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	1
4	Vibrator	Në pronësi ose me qira	1
5	Autovinc deri ne 5 ton	Në pronësi ose me qira	1
6	Vinc kulle	Në pronësi ose me qira	1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -certifikata e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -kontrata e qirasë; -certifikata e pronësisë së qiradhënësit; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
- Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / akt-zhdoganimi / faturë tatimore / çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e vlefshme.
- Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë për vendodhjen e mjeteve/pajisjeve të deklaruara, me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga projektuesi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë

*në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda.*

*Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Argumentimi i specifikimeve teknike :**Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivi/argumentimi i nr. të punonjeseve dhe grafiku për procedurën respektive janë hartuar nga subjekti i licensuar që ka hartuar edhe projekt/ preventivin përkatës të zbatimit duke qenë elemente perberes të tij dhe të verifikuara nga specialistet e fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të VKM nr 629 datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” i ndryshuar. (bashkëngjitur proceverbali i strukture të posaçme, për përlogaritjen e fondit limit)

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

## **NJESIA E PROKURIMIT**